

VENDIM
Nr. 11, datë 27.2.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME PUKË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,
në mbledhjen e datës 27.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë Sh.a për licencim,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Pukë (UK Pukë), me shkresën nr. 22 prot., datë 16.1.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik të UK Pukë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) UK Pukë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63;

b) Shoqëria UK Pukë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 15 715 banorë në Bashkinë Pukë;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Pukë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pukë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me

kufizimin e tregjeve;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, veçanërisht, në lidhje me organizimin e njësive të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si shoqëri aksionare sipas sistemit me një nivel administrimi.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Pukë, rekomandon:

- Shoqëria UK Pukë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për rishikimin e nivelit tarifor pas riorganizimit të shoqërisë sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Pukë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. me NUIS J69310307F, në kategoritë:

a) Kategoria A - për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor - Petrit Dedaj;

b) Drejtues teknik - Hydajet Kuçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës- Kanalizime Pukë sh.a. është Bashkia Pukë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani